



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2020:041865

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01516936

P.nr.15/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË-

Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Emine Salihu, me Ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.. K., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm PP.II-nr.332/20 të datës 05.03.2020, të cilën e përfaqsonte prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 08.02.2020, në prezencë të palëve mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri N.. K., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati B., dhe e ëma Sh..., e lindur M., i lindur më dt. 29.06.1986, në Gjilan, me vendbanim të përhershëm ne Gjilan, Rr “ ”, nr., i martuar, babë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme të tregtisë, punëtor në fermën e bagëtive në Fsh.D., K.Novobërdë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Me datë 14.02.2020, rreth orës 15.10min, në Fsh.K.. e , të Komunës së Novobërdës, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur “P.”, me qëllim të vjedhjes ka pre trungje në këtë pyll dhe sasisa e druve të prerë ka tejkaluar 5(pesë) metra kub, në atë mënyrë që ka shkuar në pyllin e lartpërmendur dhe aty me sharrë motorike i kanë pre 62 trungje të bungut, me diametër në cung 15-35cm, në lartësi të drurit 15-27 cm, dhe vëllim të përgjithshëm prej :6.88 m3, në

vlerë gjithsej :844,64 euro dhe më pas ato i ka bartur me traktor te markes “Rakovica”, me ram, me q’rast APK-në në Novobërdë e ka dëmtuar për këto dru apo kundërvlerën e tyre në të holla.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4,38, 42, 46, 47, 48, 50, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit, i shqipton:

Ashtu që të akuzuarit N. K., ti caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 Euro (Pesë qind Euro), të cilën gjobë i pandehuri do ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, te cilin dënim ka për ta paguar ne dy keste, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashhtë) muajve të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale e në të kundërtën gjykata do t’ia revokoj dënimin me kusht.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 Euro të gjobës.

E dëmtuara APK, në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari ti paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25(njëzetë e pesë) Euro, si dhe në emër të hargjimeve procedurale shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i pandehuri N.. K., obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.332/20 të datës 05.03.2020, ndaj të pandehurit N.. K..., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhja pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

I pandehuri N. K., në shqyrtimin fillestar të mbajtur ka deklaruar : se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores së shtetit e kam kuptuar në tërësi,e ndiej

vehtën fajtor dhe e pranoj fajsinë, është hera e parë që ndeshem me ligjin, i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë. Pranimin e fajit e bej vullnetarisht pa kurfarë dhune dhe presioni dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, ndiej keqardhje dhe pendohem shume dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale ose të natyrës së njëjtë, nuk i kam ditur pasojat e kesaj vepre penale, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë dhe betohem se kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit. Nisur nga ajo që gjykata të më shqiptojë një dënim sa më të butë meqë jam mbajtës i 2 fëmijëve të mitur-mbajtës i familjes, drut të cilat i kam marrë në pronën shtetërore të datës kritike i kam marrë ekskluzivisht për nevojat e mija personale – për djegie, meqë jetojmë bashkë me vëllaun me familje dhe nënën time.

Perfaqesuesja e akuzës, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2020, deklaroj: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse pranimi është i mbështetur në provat tjera materiale në shkresat e lëndës andaj konsideroj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që në tërësi ta aprovoja pranimin e fajësisë se të pandehurit.

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit dhe të akuzuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pandehuri N.. K., nga Gjilani, e ka kryer veprën penale Vjedhja pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

Gjyqtarja e vetëme gjykuese, shpalli fajtor të pandehurin N... K..., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë, sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre, është penduar, i gjendjes së vështirë ekonomike.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit N.. K., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.15/2020

Më:08.02.2020

*Ref. e lartë
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:041865
Datë: 18.02.2021
Numri i dokumentit: 01516936